

Kush jemi ne?


Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është organizatë joqeveritare dhe jopërfituese e themeluar nga Fondacioni "Soros" në vitin 2000. KEC përqendrohet kryesisht në trajnimin e punëtorëve të arsimit për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të udhëheqjes, por edhe në zhvillimin e një varg aktiviteteve të tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit në Kosovë.

Të arriturat kryesore të KEC në periudhën e deritanishme janë:

- Trajnimi i rreth 20,000 mësimdhënësve dhe administratorëve të të gjitha niveleve të arsimit.
- Zhvillimi i programeve specifike të trajnimit për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe për udhëheqje efektive në arsim, në planifikim, të drejtat e fëmijës etj.
- Publikimi i mbi 25 titujve nga fusha e arsimit dhe i një numri të madh studimesh.

KEC ka rreth 100 bashkëpunëtorë të jashtëm, nga Kosova dhe Rajoni. Partnerët kryesorë të KEC janë: Komisioni Evropian, MASHT, Fondacioni "Soros", Banka Botërore, UNICEF, USAID dhe një numër i konsiderueshëm organizatash të tjera qeveritare dhe joqeveritare.

Më shumë informacione për programet dhe projektet e KEC, mund të gjeni në www.kec-ks.org



Informatat dhe regjistrimet:

Shkolla "Mileniumi i Tretë"
rr. Isa Kastrati p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel. **038/244 258**
E-mail: info@mileniumi3.net
<http://www.mileniumi3.net>

Çdo ditë pune prej orës **8.00-16.00**



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC



Mileniumi i Tretë

www.mileniumi3.net

Koncepti i Shkollës "Mileniumi i Tretë"

Shkolla "Mileniumi i Tretë" është shkollë jopublike e nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (klasat 1-12), e themeluar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Objektet e Shkollës ndodhen në Prishtinë, rr. "Isa Kastrati", p.n., në një mjedis të qetë dhe të sigurtë, rreth 1 km largësi nga shkolla "Iliria" në drejtim të Matiçanit. Objektet kanë një sipërfaqe prej rreth 4,500 m². Në kuadër të kompleksit të shkollës përfshihen fushat sportive dhe restoranti.

Shkolla "Mileniumi i Tretë" nuk u shërben vetëm nxënësve të saj dhe prindërve të tyre, por edhe arsimit publik. Pas mbulimit të shpenzimeve të Shkollës, profiti i realizuar shfrytëzohet për aftësimin profesional të mësimit të shkollave publike, duke i kontribuar kështu ngritjes së cilësisë së arsimit në përgjithësi.

të mësimit, përfshirë teknikat e programit me reputacion ndërkombëtar "Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit", mësimit problemor, mësimit me anë të projekteve, etj.



Nxënësit brenda ditës i kalojnë në shkollë 6-8 orë, në varësi nga mosha dhe nevojat individuale, duke kryer pjesën më të madhe të obligimeve të tyre gjatë këtij orari. Për këtë qëllim është ndërtuar një sistem logjistik, i cili përfshin organizimin e transportit, një orar jokonvencional të mësimit, ofrimin e mundësive për aktivitete jashtëmësimore etj.

Organizimi i punës në shkollë

Shkolla "Mileniumi i Tretë" punon me plane dhe me programe të avancuara të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, duke shfrytëzuar çdo mundësi për qasje inovative.

Mësimi në klasat e ulëta zhvillohet sipas metodologjisë së mirënjohur "Hap pas hapi", ndërsa mësimi me fëmijët e moshës 11-15 vjeçare zhvillohet me metoda bashkëkohore

të aktiviteteve kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, etj. Kjo asistencë teknike nënkupton angazhimin e kohëpaskohshëm të ekspertëve, të cilët do të punojnë me mësimit të avancimit të punës së tyre. Shumica dërrmuese e mësimit të angazhohen me orar të plotë pune në shkollë.

Ju pretojme...

- Krijim të mjedisit të përshtatshëm për zhvillim maksimal fizik dhe psikik të fëmijëve.
- Krijim të sensit tek fëmijët për vlerësimin e tipareve pozitive, siç janë: sinqeriteti, drejtësia, vetëbesimi, guximi qytetar, respekti ndaj të tjerëve, etj.
- Trajtim korrekt dhe jodiskriminues të të gjithë fëmijëve dhe të prindërve.
- Zhvillim të aftësive kreative të nxënësve dhe të aftësisë për të mësuar gjatë tërë jetës.
- Kultivim të aftësisë drejtshkrimore në përputhje me standardet e gjuhës amtare.
- Aftësim të fëmijëve ta flasin dhe ta shkruajnë rrjedhshëm gjuhën angleze, të lexojnë dhe komunikojnë pa probleme në një gjuhë tjetër të huaj.
- Shkallë maksimale të zhvillimit të aftësive psiko-fizike të fëmijëve.

Personeli

Shkolla ka të punësuar mësimit të kualifikuar, të cilët tregojnë prirje të veçantë për aplikimin e risive në procesin mësimor. Për mësimit të ekziston një program i zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe u ofrohet asistencë e vazhdueshme teknike në fushën e didaktikës, vlerësimit, planifikimit